



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1898 Prot.

Vlorë, më 09/06/2022

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori, subjekti “Laurenc Mërtiri” me ID H50509075A, me banim në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.112, me Nr.3207/1 Prot., datë 21/10/2021, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 13.248 (Trembëdhjetëmijë e dyqindedyzetetë) lekë, për deklaratën doganore IMP- 4 me numër R 6279, datë 15.06.2019, ndaj subjektit debitor “Laurenc Mërtiri” p.f me ID H50509075A, me banim në Fier (“Liko Dhima”, Ndërtesa 19, Hyrja 1). Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Laurenc Mërtiri” p.f, me anë të Shërbimit Postar, si dhe me anë të lajmërimit public.

Personi fizik debitor “Laurenc Mërtiri”, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.112, me Nr.3207/1 Prot., datë 21/10/2021, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor. Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.112, me Nr.3207/1 Prot., datë 21/10/2021, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Fatos Likaj”, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

VENDOSA:

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit fizik - “Laurenc Mërtiri”, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik - “Laurenc Mërtiri”, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi fizik - “Laurenc Mërtiri”, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 13.248 (Trembëdhjetë mijë e dyqindëdyzetetë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.112, me Nr.3207/1 Prot., datë 21/10/2021, të Degës së Doganës Vlorë, si dhe kamatë vonesën e lindur.

KRYETAR
Artan Bedinaj

